

## FORMULARI PËR VLERËSIMIN CILËSISË SE APLIKACIONEVE:

Kriteret e vlerësimit janë të ndarë në disa fusha të vlerësimit. Në çdo fushë të vlerësimit janë caktuar pikët në mes të 1 dhe 5, në përputhje me kategoritë e mëposhtme të vlerësimit: 1 = nuk është e mjaftueshme, 2 = mjaftueshëm, 3 = mirë, 4 = shumë mirë, 5 = shkëlqyeshëm.

<b>A. Kapaciteti institucional i aplikantit/partnerit</b>	<b>Pikët (30)</b>
A.1 A posedon aplikanti dhe partnerët përvojë të mjaftueshme dhe kapacite profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë thirrje)?	(1 2 3 4 5) x 2
A.2 A posedojnë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme aplikanti dhe partnerër (duke përfshirë personelin, pajisjet dhe aftësinë për të udhëhequr me buxhetin e projektit/programit)?	(1 2 3 4 5) x 2
A.3 A ka një strukturë të qartë që do të merret me menaxhimin e projektit? A është e përcaktuar qartë ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit?	(1 2 3 4 5) x 2
<b>Numri i përgjithshëm i pikëve (30 pikë maksimale)</b>	
<b>B. Relevanca e projektit/programit</b>	<b>Pikët (30)</b>
B.1 Sa relevant është projektpropozimi për qëllimet dhe fushat prioritare të thirrjes( a ndërlidhen projekti me aktivitetet e parapara në strategjitë dhe politikat prioritare të fushës që mbulon thirrja publike?	<b>1 2 3 4 5</b>
B.2 A janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?	<b>1 2 3 4 5</b>
B.3 A janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?	<b>1 2 3 4 5</b>
B.4 A janë përcaktuar qartë rezultatet dhe nëse aktivitetet çojnë në arritjen e rezultateve?	<b>1 2 3 4 5</b>
B.5 A ka arritur projekti/programi të përcaktojë në mënyrë të qartë përdoruesit (numrin, moshën, gjininë, etj)? A përcakton dhe në çfarë mase adreson problemet dhe nevojat e tyre projekti?	<b>1 2 3 4 5</b>
B.6 Deri në çfarë mase janë rezultatet e projektit të qëndrueshme? A anë të dizajnuara mirë mekanizmat e menaxhimit të rrezikut në zbatimin e projektit?	<b>1 2 3 4 5</b>
<b>Numri i përgjithshëm i pikëve (30 pikë maksimale)</b>	
<b>A. Buxheti (shpenzimet)</b>	<b>Pikët (20)</b>
C.1 A janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?	(1 2 3 4 5) x 2
C.2 A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?	(1 2 3 4 5) x 2
<b>Numri i përgjithshëm i pikëve (20 pikë maksimale)</b>	
<b>D. Në ç' masë ndikon projekti në adresimin e PRIORITETEVE TË THIRRJES:</b>	<b>Pikët (20)</b>
D.1 Rritjen e shkallës së arritjes në mësim dhe të vijueshmërisë së nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë në shkollë?	<b>1 2 3 4 5</b>

D.2 Ngritjen e kapaciteteve të stafit të qendrës mësimore në ofrimin e mësimimit cilësor për fëmijët që e vijojnë atë?	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
D.3 Ndërgjegjësimin për rëndësinë e shkollimit të detyrueshëm.	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
D.4 Përmirësimin e bashkëpunimit mes qendrave mësimore, shkollave dhe drejtorive komunale të arsimit?	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
<b>Numri i përgjithshëm i pikëve (20 pikë maksimale)</b>					
<b>TOTALI (pikët maksimale 100)</b>					

Vlerësimi përshkruet i projektit/programit

Vlerësimi përshkruet e projektit duhet të jetë në përputhje me vlerësimin që është bërë përmes pikëve numerike.

Secili anëtar i Komisionit vlerësues do të bëjnë vlerësimin në mënyrë të pavarur të propozimeve, dhe vlerësimet e tyre do të bëhen në shkallën nga 1 deri në 5 për secilën pyetje të parashtruar në formën e vlerësimit. Komisioni vlerësues do të përgatis listën e përkohshëm duke mbledhur pikat individuale të të anëtarëve të komisionit dhe llogaritjen e mesatares së këtyre pikëve të regjistruar në një formë të përbashkët të kërkesave individuale dhe e cila përfshinë numrin e përgjithshëm të pikëve që projekti ka marrë. Radhitja në listë e projekteve do të bëhet sipas numrit të pikëve që kanë marrë në procesin e vlerësimit. Nga më e larta tek më e ulëta. Do të financohen vetëm atë projekte, shuma totale e të cilave nuk e tejkalon shumën e planifikuar në kuadër të thirrjes publike.

Projektet të cilat gjatë procedurës së vlerësimit nuk arrijnë minimumin prej 50 pikësh nuk do të financohet me anë të kësaj thirrje në asnjë rast.